



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/12

Datë: 21.04.2026


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7, paragrafi 4, të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. I propozohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ratifikimi i 3 (tre) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, si në vijim:
 - 1.1. Në shkencat mjekësore:
 - 1.1.1. Driton Vela.
 - 1.2. Në shkencat humane:
 - 1.2.1. Florim Gallopeni.
 - 1.3. Nga radhët e studentëve:
 - 1.3.1. Shkurtë Bajgora.
2. Mandati i anëtarëve sipas pikës 1. të këtij Vendimi fillon vetëm pas përfundimit të mandatit të anëtarëve të KSHC-së për fushat përkatëse.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin së bashku me biografite e të propozuarve nga pika 1. e këtij Vendimi t'ia procedoj Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë